



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS

NJESIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSION I SALLËS SË MBLEDHJEVE TË
KËSHILLIT BASHKIAK, AMBJENTEVE TË ISH ASHK-SË DHE KATIT PËRDHE
DHE KATIT TË PARË TË GODINËS SË BASHKISË KUKËS”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

(CPV): 45213150-9

**VLERA E FONDIT LIMIT: 8,079,645 (tete milion e shtatedhete e nente mije e gjashtëqind e
dyzet e pese leke, pa TVSH.**

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78,pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar),autoriteti/enti kontraktor BASHKIA KUKËS ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP(I ndryshuar), dhe nenin 26, neni 30, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(I ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas *shtojcës 8 të DST*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP(I ndryshuar), nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(I ndryshuar),si dhe ne Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", te ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. (*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivit*).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" (i ndryshuar). Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur/fondit limit të kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" (i ndryshuar) në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës në procedurat nën kufirin e ulët monetar.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedura e Hapur e Thjeshtuar-Punë" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit1, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....,

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet .

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
 - Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes në dorëzim;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer), shoqëruar me:
 - Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Fatura tatimore të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”...Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:a) Për kontratat e punëve:*

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e vlerës monetare, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **vlera limit e kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këto mënyra, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), ., Udhezimi i K.M nr.2 ,datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 ”Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “ të ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zërat e punimeve që ka realizuar, koha e

realizimit , dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te objektit si dhe vleresimi i dhene nga Autoriteti Kontraktor,elemente te nevojshem per te gjykuar per plotesimin e kriterëve per pune te ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”*, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP-3 – Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S-2 – Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër,

mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

N.S-14 – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kategoria e kërkuar	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Kategoritë me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-3	A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	<ul style="list-style-type: none"> -Prishje suvatim muri i brendshem -Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese -Mur tulle me vrima, t=20cm -Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15 -Brez b/a C20/25 -F V konstruksione metalike te perbera -Prishje mur tulle me pastrim 	0-20,000,000 lekë

NS-2	A	Impiante termosanitare mirëmbajtja e tyre	hidro-dhe -Heqje pajisje hidrosanitare -Heqje lavaman -Heqje WC + kasete -F.V lavaman porcelani -F.V WC allafrenga -F V bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar	0-20,000,000 lekë
NS-4	A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	-F V dritare plastike me dopio xham -F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I-re. -Shtrese parketi laminat -Veshje tavani me kartonxhes -Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 -Boje hidroplastike cilesi e larte -Heqje pllakash majolike -Shtrese me pllaka mermeri t=3cm -Veshje me pllake majolike -Patinim muri allçi (stuko) -Patinim tavani allçi (stuko)	0-20,000,000 lekë

			-Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm -Boje hidroplastike	
NS-14	A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	-F.V. Ndricules tip plafoniere ,me llampe fluoeshente 40w,(60x60) -F.V kuti suport pllaket 4 mod -F.V tub plastmasi Ø 31-36mm -F.V tub plastmasi Ø 11-13mm -F.V tub plastmasi Ø 14-17mm -F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm ² -F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm ² -F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim -F.V kuader ndriçimi -F.V priza shuko universal	0-20,000,000 lekë

- sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, sipas lidhjeve 2 dhe 3, Vendim Nr. 759, Datë 12.11.2014 Për Licencimin Profesional të Individëve dhe Subjekteve Juridike që do të Ushtrojnë Veprimtari në Fushën e Studimit e të Projektimit në Ndërtim dhe Mbikëqyrjes e Kolaudit të Punimeve të Zbatimit në Ndërtim. Përcaktimi i kategorisë së licensave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Çertifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim (ose të njevlëshme me to).
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim (ose të njevlëshme me to).

- Çertifikatë **ISO 45001-2018** mbi “Sistemi i menaxhimit të shendetit e sigurise ne pune” ose ekuivalent.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave që merr përsipër të realizoje në aktmarrëveshje.

Pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shendetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.3.4 Operatoret ekonomik duhet te paraqesin makinerite dhe pajisjet e nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Auto > 1.5 t	Në pronësi, qira ose kontratë	Copë	2
4	Autovinc deri 2.5 t	Në pronësi, qira ose kontratë	Copë	1

6	Trapano elektrike	Në pronësi, qira ose kontratë	Copë	1
7	Zmeriletrice	Në pronësi, qira ose kontratë	Copë	1
8	Pompe suvatimi	Në pronësi, qira ose kontratë	Copë	1
9	Vibrator	Në pronësi, qira ose kontratë	Copë	1
10	Saldatrice elektrike	Në pronësi, qira ose kontratë	Copë	1
11	Gazogjen 1 m ³ /ore	Në pronësi, qira ose kontratë	Copë	1

2 (dy) auto me kapacitet më të lartë se 1.5 t: kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të nevojiten për transportin e materialeve ndërtimore dhe inerteve.

1 (një) autovinc deri 2.5 ton: kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për ngritjen, pozicionimin dhe montimin e elementeve të konstruksioneve metalike apo elementë të ndryshëm.

1 (një) trapano elektrike: kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për shpime në mur, beton, tulla dhe elementë të tjerë ndërtimorë, si dhe montimin e instalimeve elektrike, sanitare, dyer dhe dritare.

1 (një) zmeriletrice: kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për prerje, lëvim dhe përpunim të metaleve, drurit, pllakave gjatë punimeve të montimit dhe përfundimit.

1 (një) pompë suvatimi: kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për aplikimin mekanik të llacit në mure dhe tavane, duke rritur shpejtësinë e punës dhe cilësinë e suvatimit.

1 (një) vibrator: kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për ngjeshjen e betonit, eliminimin e boshllëqeve të ajrit dhe rritjen e rezistencës së elementëve prej betoni.

1 (një) saldatrice elektrike : kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për kryerjen e saldimeve metalike në punimet e konstruksioneve metalike.

1 (një) gazogjen 1m³/orë : kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për prerje dhe saldime me flakë të elementeve metalike, nxehje materialeve dhe punime të posaçme metalike.

Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f) Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Shenim: Per kete pike 2.3.4 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar). Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në

dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim permbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr.216 datë 13.04.2023 “Për krijimin e dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” si dhe VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

2.3.5 Staf kryesor Teknik e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për keto punime.

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Ing. Ndërtimi 1 (një)
- Teknik ndërtimi 1 (një)
- Ing. elektrik 1 (një)
- Ing. hidroteknik 1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **3 muajt e fundit** . Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune noteriale (*e vlefshme*).

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

Shenim: Per kete pike 2.3.5 a) dhe b) te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr.285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Kjo kërkesë është kërkuar që të sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe ploteson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht **27 (njëzetë) punonjës.**

- Muratorë 2 (dy)
- Elektriciste 3 (tre)
- Hidraulik 1 (një)
- Specialistë gipsi 2 (dy)
- Saldator 1 (një)
- Montues dyer-dritare 2 (dy)
- Marangozë 2 (dy)
- Punëtorë ndihmës 7 (shtatë)
- Manovratorë 1 (një)
- Shoferë 2 (dy)

Gjithsej: 27 punonjës

1 (një) inxhinier ndërtimi: Prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses, mbikëqyrjen teknike dhe realizimin e çdo faze punimi.

1 (një) teknik ndërtimi: prezenca e tij është e nevojshme për asistencë teknike dhe koordinim gjatë zbatimit të punimeve ndërtimore.

1 (një) inxhinier elektrik: prezenca e tij është e nevojshme për organizimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha punimeve elektrike të parashikuara sipas kushteve teknike dhe standardeve të sigurisë elektrike.

1 (një) inxhinier hidroteknik: prezenca e tij është e nevojshme për drejtimin dhe kontrollin e punimeve hidro-sanitare për të siguruar zbatimin korrekt të instalimeve, funksionalitetin e sistemeve dhe përputhjen me normat teknike.

2 (dy) muratorë: kjo kërkesë nevojitet për realizimin e punimeve të muraturës, prishjet, suvatimet, riparimet dhe shtresimet e ndryshme të parashikuara në preventiv.

3 (tre) elektrikistë: kjo kërkesë nevojitet për zbatimin e instalimeve elektrike, vendosjen e tubacioneve, kablllove, prizave, ndricuesve dhe lidhjen funksionale të sistemit elektrik.

1 (një) hidraulik: kjo kërkesë nevojitet për montimin dhe mirëmbajtjen e instalimeve hidrosanitare dhe pajisjeve të tjera sanitare.

2 (dy) specialistë gipsi: kjo kërkesë nevojitet për realizimin e tavaneve të varura.

1 (një) saldator: kjo kërkesë përputhet me zërat e punimeve të preventivit që përfshijnë punimet me konstuksion metalik.

2 (dy) montues dyer-dritare: kjo kërkesë nevojitet për cmontimin e elementëve ekzistues dhe montimin e dyerve, dritareve dhe vetratave të reja.

2 (dy) marangozë: kjo kërkesë nevojitet për montimin dhe rregullimin e elementëve prej druri ose mobilimit, tavolina, mobilje te brendshme dhe punime të tjera dekorative.

7 (shtatë) punëtorë ndihmës: kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen për kryerjen e punimeve ndërtimore.

1 (një) manovrator: referuar volumeve të punës si dhe mjeteve të nevojshme si autovinç për punët që do të realizohen të cilat kërkojnë manovrim profesional.

2 (dy) shoferë: kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, referuar volumeve të punës si dhe mjeteve të nevojshme për punët që parashikojnë transportin e materialeve ndërtimore ose inerteve.

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen **Tremujorin e fundit**

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Tremujorin e fundit.**

Shenim: Per kete pike 2.3.6 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate .

2.3.7 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, (nese nuk ka në fushën e veprimtarisë te percaktuara ne ekstrakt paisjet/mallrat e listuara ne kete pike te DTS-se) si më poshtë:

Specifikime Teknike per Pajisjet dhe Analiza Teknike e Zerave te Punes ne Preventiv (te percaktuara nga grupi I perlllogaritjes)*

MOBILIMI DHE PAJISJE TË BRENDSHME	NJËSIA	SASIA
Kondicioner 18 BTU	1	copë
Tavoline	1	copë
Karrike	45	copë
Perde	3	copë
Stol me detaje dekorative	2	copë
Sistem Elektronik I Identifikimit te Punonjesve	1	copë
Pllakatë emërtim institucioni	1	copë
Leter Murale	1	komplet
Sistem Audio	75.48	m ²

I. PAJISJE (PJ)

Tetër muri: Material vinil/tekstil, trashësi ≥ 0.3 mm, rezistent ndaj lagështirës, përfshin furnizim, përgatitje sipërfaqeje dhe montim.

Pllakatë emërtimi institucioni: Material alukobond, përmasa 6x0.8 m, rezistencë ndaj kushteve atmosferike, montim me strukturë metalike.

Stol dekorativ: Strukturë metalike dhe druri, rezistencë ≥ 250 kg, për përdorim të brendshëm.

Kondicioner 18 BTU: Tip inverter, klasë energjie A+, gaz R32/R410A, përfshin instalim të plotë.

Tavolinë: Material MDF ose dru, strukturë metalike, rezistente ndaj konsumit.

Karrige: Ergonomike, strukturë e përforcuar, për përdorim intensiv.

Perde: Material tekstil, përfshin mekanizëm dhe montim.

II. ANALIZA (ANL) – SISTEM AUDIO

Sistemi audio duhet të sigurojë transmetim të qartë të zërit dhe mbulim uniform në ambient.

Njësi qendrore (MMU): Kontrollon sistemin e mikrofonave, mbështet ≥ 25 njësi.

Mikrofona podiumi: Tip gooseneck, me buton aktivizimi dhe prioritet për kryetarin.

Mikrofon ëireless: Teknologji UHF/VHF, distancë ≥ 30 m.

Boksë tavani: Tip inkaso, fuqi $\geq 20-40$ Ë, shpërndarje uniforme.

Kabllim: Kabllo dhe lidhje profesionale, instalim i sigurt.

III. SISTEM KONTROLI AKSESI DHE IDENTIFIKIMI

Ky zë përfshin furnizimin, instalimin dhe vënien në punë të një sistemi elektronik për kontrollin e aksesit dhe identifikimin e punonjësve, i cili mundëson monitorimin dhe menaxhimin në kohë reale të hyrje-daljeve në ambientet e institucionit.

Përbërja:

Njësi kontrolli qendrore: Komunikim: TCP/IP, RS-485, Ëiegand, Menaxhim i centralizuar

Lexues RFID: Frekuencë 125 kHz dhe 13.56 MHz; Lexim i sigurt dhe i shpejtë

Karta RFID: Material PVC, Rezistente ndaj përdorimit

Bateri reserve, Kabllo dhe aksesore si dhe instalim dhe konfigurim i tyre

Kërkesa Teknike:

1. Siguri e lartë
2. Funksion i qëndrueshëm
3. Mundësi zgjerimi
4. Certifikim CE

IV. KËRKESA TË PËRGJITHSHME

- Pajisjet duhet të jenë të reja dhe me certifikim CE.

- Garanci minimale 1 vit.

- Instalimi nga personel i kualifikuar.

- Përfshihet transporti, montimi dhe testimi.

Argumentimi: Në bazë të nenit 4, nenit 36 si dhe nenit 79 pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë

19.5.2021 .Ky kriter eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikatat e mesiperme, te lidhura me objektin e prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te Autoriteti Kontraktor qe ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike per realizimin me sukses te kontrates.Në nenin 44 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikojte qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/sherbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe per shkak te interesit te larte qe ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën,duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.Për të siguruar këtë gjë, por njëkohesisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin ne menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallarave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me çertifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshjeangazhimi, skeda teknike,certifikata cilesie, certifikata konformiteti,raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do

të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotesimi i kërkesës sipas pikës 9, garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjive të reja dhe bashkëkohore. Gjithashtu në përzgjedhjen e grupit të mallrave të mësipërme të cilat do të vendosen në objekt si edhe shërbejnë për ndërtimin e objektit, është marrë në konsideratë një test balancues dhe proporcional në përzgjedhjen e tyre. Kështu është vlerësuar se në përzgjedhjen e grupit të mallrave të mësipërme të cilat do të vendosen në objekt janë marrë në konsideratë 2 faktorë, vëllimi i tyre, duke marrë në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorë dhe jodiskriminuese. Sa më sipër, materialet e sipërcituara zënë një pjesë specifike në punimet që do të kryhen në objekt, ndaj kërkesa lidhur me to është në proporcion me natyrën dhe vëllimin e punimeve.

Ky kriter i marrë në konsideratë lidhet ngushtësisht me faktin se shumica e produkteve të mësipërme kanë bazë kimike dhe kanë /mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e komunitetit etj. Akoma më tej vlerësojmë se kemi të bëjmë me një objekt kulturor ku përpuethshmëria e cilësisë së materialeve të vendosura në objekt nuk duhet të sjellë pasoja shëndetësore në shëndetin e qytetarëve etj, duhet të përmbushë nivelin ekologjik të kërkuar dhe duhet të jetë në përputhje me Standardet e Njohura në Republikën e Shqipërisë. Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcio me natyrën dhe vëllimin e kontratës dhe se i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskriminon midis operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj, pasi standardet e kërkuara është Standardi Shqiptar i cili është i harmonizuar me Standardin Europian. Gjithashtu, në përputhje dhe proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe pjesës specifike të secilës prej mallrave që do të vendosen në objekt atëherë është parashikuar që për një pjesë prej tyre të dorëohen vetëm katalogjet ndërsa për mallrat dhe pjesët të cilat kanë një ndikim të veçantë në mjedis si edhe ndikim të veçantë në shëndetin e qytetarëve, krahas katalogjeve të prodhuesit është kërkuar edhe dorëzimi i raport testeve zyrtare të lëshuar nga laboratorë të akredituar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu, kriteri i mësipërm nuk shfaq diskriminim mes operatorëve të cilët blejnë dhe ofertojnë për kryerjen e punimeve me produkte të gatshëm pasi dokumentacioni i kërkuar me siper disponohet nga çdo prodhues serioz vendas apo i huaj.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 4 (kater) muaj.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

Shenim: Specifikimet/Kriteret teknike janë hartuar nga specialisti perkates i fushes(inxhinieri) ne perputhje me nevojat teknike dhe kerkesat e objektit te prokurimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Njesia pergjegjese ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne specifikimet teknike argumenton se nuk ka permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT